**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

**Drejtoria Komunale për Prokurim Publik**
**VU644 – 24 – 7956 – 221/C950**
**14 Nr. 764/24**
**Dt. 19.09.2024**

# KONTRATË SHËRBIMI
## ( Kontratë Kornizë )

**Palët kontraktuese :**

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik**(në tekstin e mëtejmë **PORORSITËSI)** , dhe

2. **S.V. " Veteriana"** me seli në **Vushtrri,** me **ARBK: 810692857 si Operator Ekonomik**, të cilën e përfaqëson **z. Safet Osmani,** në tekstin e mëtejmë **KONTRAKTUESI – KRYESI I SHËRBIMIT**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontrate publike kornizë për ekzekutimin e shërbimeve, si vijon:

**Shërbime të Deratizimit, Dezinsektimit dhe Dezinfektimit për nevoja të A.K. - Vushtrri,** me numër identifikues:

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr. i Prokurimit** | **VU644** | 2 | 4 | 79 | 5 | 6 | 2 | 2 | 1 |
| **Nr. i brendshëm** | **VU644** | 2 | 4 | 0 | 6 | 5 | 2 | 2 | 1 |

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Shërbime të Deratizimit, Dezinsektimit dhe Dezinfektimit për nevoja të A.K. - Vushtrri** sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : **VU644-24-065-221**

1.2 **Kjo kontratë është Kontratë Publike Kornizë dhe fillon së zbatuari datën e nënshkrimit të kontratës, respektivisht nga data 19.09.2024 dhe përfundon më dt. 18.09.2026 duke përfshirë edhe këtë datë.**

1.3 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. Psh, Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Organ tjetër i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim dhe / ose ekzekutim të shërbimeve me sasitë e tyre përkatëse.

1.4 Sasitë e parapara, si në pjesën II. Lista e Çmimeve, ( pjesë e Dosjes së Tenderit të Kontraktuesit – Kryesit të Shërbimeve ) dhe të kësaj Kontrate janë vetëm sasi indikative. Ato paraqesin një prag, nga e cili mundë të lejohet një mospërputhje e cila nuk mundë të jetë më e lartë se plus / minus tridhjetë përqind ( 30 % ).

1.5 **Nëse Urdhërblerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të Kontratës Publike Kornizë, duke përfshirë edhe tridhjetë përqindëshin, pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, Kontrata Publike Kornizë do të ndërpritet automatikisht.**

1.6 Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind ( 30% ) vlenë edhe për pozicion / artikull si në Përshkrim të Çmimeve, dhe në rsat të arritjes së pragut të lejuar A.K. respektivisht Menaxheri i Kontratë nuk duhet të lejoj të bëhen porosi tjera dhe / ose të bëhen pranime tjera të shërbimeve për atë pozicion ose artikull.

1.7 Autoriteti Kontraktues është i obliguar të përdorë këtë marrëveshje kornizë kurdo që bëjnë blerjen e mallrave të përmendura në pikën 1.1.

**Neni 2 Kushtet e dërgesës**

2.1 Ekzekutimi i shërbimeve do të filloi jo më gjatë se 2 ( dy ) ditë kalendarike pas datës së dërgimit të Letër Porosisë nga personi përgjegjës – kompetent i Njësisë Kërkuese të A.K., në këtë rast Menaxheri i Kontratës i A.K., ndërsa shërbimet duhen përfunduar brenda afatit prej 5 ( pesë ) ditëve ose afatit të përcaktuar mbi bazën e marrëveshjes mes Menaxherit të Kontratës të A.K. dhe Kontraktuesit - Kryesit të Shërbimeve.

2.2 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP[1] (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

**Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve dhe / ose furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimeve e paraqitur nga Kryesi i Shërbimeve.

3.2 Vlera totale indikativë e Kontratës është: **14,894.40€ ( katrëmbëdhjetmijtetqinnëntdhjetekatër/40 Euro).**

3.3. Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve, me përjashtim nëse A.K. ka bërë porosi për ekzekutim të shërbimeve, duke shfrytëzuar edhe tridhjetpërqindëshin e lejuar sipas pikës 1.6. të nenit 1 të kësaj Kontrate Kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen : **në pajtim me sasinë ( m² ) e shërbimeve të porositura dhe / ose të aprovuar nga Menaxheri i Kontratës si dhe të konfirmuar me Raportin me shkrim nga Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues, se shërbimet e porositura prej tyre janë përfunduar në kohë, në mënyrë cilësore dhe sasiore, duke respektuar kushtet e kontratës dhe Specifikat Teknike, pjesë përbërëse e kësaj kontrate.**

**Shumat do të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore të kësaj Kontrate Kornizë si dhe Kushteve të Përgjithshme dhe / ose Kushteve të Veçanta të Kontratës pjesë e Dosjes së Tenderit.**

**3.5. Kontraktuesi ka për obligim që me rastin e fillimit të ekzekutimit të shërbimeve të respektoi detyrimet e tija në mënyrë që shërbimet të jenë cilësore, në përshtatshmëri të plotë me kushte e kontratës, të përmbushin në tërësi Specifikat Teknike të saktësuara në Dosjen e Tenderit si dhe të respektoi Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës. Kontraktuesi merr për obligim që përdorimi i preparateve të parashikuara për ekzekutimin e shërbimeve të Deratizimit, Dezinsektimit dhe Dezinfektimit të bëhet brenda parametrave të lejuar me standarde të aprovuara dhe / ose të lejuara prej organeve kompetente shtetërore dhe të cilat janë të rregulluara me legjislacionin në fuqi që rregullon këtë çështje në Republikën e Kosovës.**

**Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

---

[17] DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

(a) Marrëveshja e kontratës;
(b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
(c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
(d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
(e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
(f) Plani për menaxhimin e kontratës;
(g) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

**Neni 5 Komunikimet**

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe[2] në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për Autoritetin Kontraktues: Komuna Vushtrri**

**Për Kontraktuesin : S.V. " Veterina " - Vushtrri**

| **Emri:** | **Ilmi Azemi** | **Emri:** | **Safet Osmani** |
|---|---|---|---|
| **Pozita:** | drejtor | **Pozita:** | drejtor |
| **Nënshkrimi:** | | **Nënshkrimi:** | |
| **Data:** | 19.09.2024 | **Data:** | 19.09.2024 |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

[2] Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

**Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G. Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normenë e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin ~~0%, 8% apo 18%,~~ Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy numra pas presëjes dhjetore**

| Nr. | Përshkrimi i pozicioneve | Njësia Matëse | Sasia indikative për 24 muaj | Çmimi për njësi pa TVSH | Norma e TVSH-së në % | Çmimi për njësi (me TVSh)-€ | Totali (Pa TVSH) | TVSH | Totali (me TVSH)-€ |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I | **Deratizimi-dezinfektimi dhe dezinsektimi e objekteve të QKMF.** | | | | | | | | |
| 1 | QKMF, Rr. Çamëria nr.9 Vushtrri | $m^2$ | 577 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 386.30 | 69.53 | 455.83 |
| 2 | QMF-1+ Laboratorit, Rr. Dëshmorët e Kombit nr.180 Vushtrri | $m^2$ | 1785 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 1195.04 | 215.11 | 1410.15 |
| 3 | QMF-2, Rr. Zenun Gjocaj nr.11 Vushtrri | $m^2$ | 280 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 187.46 | 33.74 | 221.20 |
| 4 | QMF-3, Rr. Hazir Gjaka nr.114 Vushtrri | $m^2$ | 280 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 187.46 | 33.74 | 221.20 |
| 5 | QMF – Lumi Madh | $m^2$ | 130 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 87.03 | 15.67 | 102.70 |
| 6 | QMF - Smrekonicë | $m^2$ | 130 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 87.03 | 15.67 | 102.70 |
| 7 | QMF - Pantinë | $m^2$ | 188 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 125.86 | 22.66 | 148.52 |
| 8 | QMF – Druar | $m^2$ | 120 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 80.34 | 14.46 | 94.80 |
| 9 | QMF – Maxhunaj | $m^2$ | 120 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 80.34 | 14.46 | 94.80 |
| 10 | QMF – Novolan | $m^2$ | 136 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 91.05 | 16.39 | 107.44 |
| 11 | QMF - Dumnicë | $m^2$ | 115 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 76.99 | 13.86 | 90.85 |
| 12 | AMF - Oshlan | $m^2$ | 122 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 81.68 | 14.70 | 96.38 |
| 13 | AMF – Samadrexhë | $m^2$ | 120 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 80.34 | 14.46 | 94.80 |
| 14 | AMF – Dubovc | $m^2$ | 120 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 80.34 | 14.46 | 94.80 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 15 | AMF – Ceceli | $m^2$ | 110 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 73.64 | 13.26 | 86.90 |
| 16 | AMF – Beçiq | $m^2$ | 120 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 80.34 | 14.46 | 94.80 |
| 17 | AMF – Pasomë | $m^2$ | 120 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 80.34 | 14.46 | 94.80 |
| 18 | AMF – Strofc | $m^2$ | 120 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 80.34 | 14.46 | 94.80 |
| | **NËNTOTALI I** | | | | | | 3,141.92 | 565.55 | 3,707.47 |
| **II** | **Deratizimi-dezinfektimi dhe dezinsektimi i objekteve të Administratës Komunale dhe IP Folesë** | | | | | | | | |
| 1 | Objekti kryesor i komunës | m2 | 3110 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 2082.12 | 374.78 | 2456.90 |
| 2 | Aneks objekti i Drejtorisë për kadastër | m2 | 575 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 384.96 | 69.29 | 454.25 |
| 3 | Deratezimi-dezinfektimi-dezinsektimi i objekteve të institucionit parashkollor Foleja | m2 | 10240 | 0.67 | 18.00 | 0.79 | 6855.59 | 1234.01 | 8089.60 |
| | **NËNTOTALI II** | | | | | | 9,322.67 | 1,678.08 | 11,000.75 |

## R E K A P I T U L I M I

| Nr. | Përshkrimi | Vlera me TVSH në € |
|---|---|---|
| 1 | Deratizimi-dezinfektimi dhe dezinsektimi e objekteve të QKMF. | 3,707.47 |
| 2 | Deratizimi-dezinfektimi dhe dezinsektimi i objekteve të Administratës Komunale dhe IP Folesë | 11,000.75 |
| | TOTALI I PËRGJITHSHËM = | **12,464.59** |
| | TVSH= | **2,243.63** |
| | TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TVSH = I+II: | **14,708.22** |

| IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE) | |
|---|---|
| EMRI I OE: | S.V. "Veterina" |
| EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE: | Safet Osmani |
| NËNSHKRIMI: | |
| DATA: | 26.08.2024 |
| VULA: | |